



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1016/1 Prot.

Tiranë, më 01 . 07 . 2021

V E N D I M

Nr. 124, Datë 01 . 07 . 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 164, datë 30.12.2020, të J.Ç kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë (DRSHSSH Tiranë), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga ankuesi në dokumentacionin e dërguar dhe me e-mail-et datë 15.01.2021 dhe 18.01.2021, në mes të tjerash informon se: *“Prej 6 vitesh ka humbur të dyja këmbët dhe është trajtuar me pagesë të aftësisë së kufizuar dhe përfitimin e ndihmësit personal. Në dhjetor të këtij viti i kanë hequr përfitimin e ndihmësit personal. Pasi ka kërkuar informacion pranë Njësisë Administrative nr. 4, punonjësja që mbulon përkrahjen sociale e ka informuar se procedurat kanë ndryshuar dhe ndihmësi personal mund të jetë hequr për shkak se ai është në punë. Ankuesi deklaroi se prej 6 vitesh, para se të dilte në komision bënte vizitë tek kirurgu i cili e referonte që duhet të kishte patjetër shoqërues, ndërsa këtë vit është hequr vizita tek kirurgu dhe ka ndodhur që i kanë hequr shoqëruesin. Ankuesi shprehet se ka 6 vite që punon, me kohë të pjesshme por pagesa që ai përfiton shkon më së shumti për të mbuluar kostot e makinës dhe mirëmbajtjen e protezave. Ankuesi informon se është i martuar me dy fëmijë dhe kjo situatë e*

¹ Referuar dokumentit “Vërtetimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar” të SHSSH, J.Ç ka diagnozën me Kodin ICD T13.6 (amputacion traumatik i anësive të poshtme e paprotezuar).

rëndon dhe më shumë gjendjen e tij ekonomike. Në datë 29.12.2020, me anë të shërbimit postar është ankuar pranë KMCAP Epror por nuk ka marrë përgjigje”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e ndihmësit personal.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221/2010, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në nenin 20, pikat 1 dhe 2, gërma c), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohe të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:.....2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:.....c) Kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.*

Diskriminimi për shkak të “gjendjes shëndetësore” është shkak i mbrojtur nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në të cilin në nenin 1 dhe 3/1, parashikon se: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasoje pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 133, datë 20.01.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituarat:
 - Kopje të praktikës shkresore/procedurës së ndjekur nga DRSHSSH Tiranë, lidhur me rastin e J.Ç.
 - Informacion, statistika, nëse ka praktika të njëjta apo të ngjashme për persona të ndodhur në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin, për të cilët nga ana e DRSHSSH Tiranë është ndjekur e njëjta praktikë. Kopje të praktikave të ngjashme.
- Në mungesë të përgjigjes së Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, me shkresën nr. 133/1, datë 23.02.2021, Komisioneri i është drejtuar sërish, përmes një shkrese kujtesë për dërgimin e informacionit, duke e njoftuar përsëri që të paraqesë parashtrimet mbi çështjen në fjalë.

Me shkresën nr. 252/1, datë 25.02.2021, të administruar pranë Komisionerit me nr. 133/2, datë 03.03.2021, DRSHSSH Tiranë në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Në bazë të VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, Kreu III. Vlerësimi biopsikosocial, pika 2, përcaktohet se: “Vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizuar dhe i nivelit të kufizimeve funksionale bëhet në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar mbi Funkcionimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ky vlerësim përfshin faktorët që dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët, në përputhje me udhëzuesit për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar për të rriturit dhe fëmijët, të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe për shëndetësinë”. Dokumentacioni i J.Ç është shqyrtuar nga komisioni biopsikosocial dhe është vlerësuar përfitues i nivelit të 3 (i rëndë) pa ndihmës personal. J.Ç ka bërë ankim për përfitimin e ndihmësit personal, ankim i cili ndodhet në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH. Ankuesi do të njoftohet për datën dhe orën e zhvillimit të vlerësimit nga Komisioni i shqyrtimit të ankesave në SHSSH. Përsa i përket statistikave janë dhe dy praktika të ngjashme (L.M dhe L.V) me J. Ç të cilat janë vlerësuar nga komisioni në nivelin 2 (i moderuar)”*.

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 164, datë 30.12.2020, Komisioneri me shkresën nr. 558, datë 30.03.2021 njoftoi, Shërbimin Social Shtetëror dhe DRSHSSH Tiranë për zhvillimin e një seance dëgjimore, duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
 - Argumentimin lidhur me arsyet e mospërfitimit të ndihmësit personal për J.Ç nga ana e Komisionit shumëdisiplinar.

- Përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, lidhur me ankimin e bërë nga J.Ç për mospërfitimin e ndihmësit personal.
- Informacion, nëse ka praktika të njëjta për persona të ndodhur në kushte të njëjta me J.Ç, të cilët kanë nivelin e dëmtimit të aftësisë së kufizuar “I rëndë”, përcaktimin e përfitimeve “Niveli 3, i rëndë”, të cilët e kanë përfituar më përpara ndihmësin personal dhe tani nuk e përfitojnë atë. Nëse ka, kopje të praktikave.
- Kopje të Udhëzuesit për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar për të rriturit.

Në seancë dëgjimore mori pjesë vetëm subjekti ankues. Subjektet e njoftuara për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, SHSSH dhe DRSHSSH Tiranë nuk u paraqitën, pavarësisht se kishim marrë njoftim nëpërmjet shërbimit postar². Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Në vijim të procedurës së shqyrtimit të ankesës, DRSHSSH Tiranë me shkresën nr. 440/2, datë 20.04.2021, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Në VKM-në nr. 722, datë 11.11.2019, vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizuar përfshin faktorët që dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët, në përputhje me udhëzuesit për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar për të rriturit dhe fëmijët. Dokumentacioni i J.Ç është shqyrtuar nga komisioni biopsikosocial dhe është vlerësuar përfitues i nivelit të 3 (i rëndë) pa ndihmës personal. Ky vendim është bazuar në udhëzimin biopsikosocial/dëmtimet ortopedike/amputacioni traumatik i anësive të poshtme, e paprotezuar. J.Ç i ka të protezuara të dy gjymtyrët e poshtme duke zvogëluar kështu nivelin e vështirësisë në aktivitetin e përditshëm dhe bazë të jetës. Referuar udhëzuesit dhe vlerësimit biopsikosocial e njëjta praktikë është ndjekur edhe në raste të ngjashme, si vijon: - V.M komisionuar në datë 13.01.2021, me diagnozë amputacion traumatik të gjymtyrëve të poshtme, e paprotezuar, rezulton përfituese e nivelit të moderuar. – M.T me diagnozë amputacion traumatik të anësive të poshtme, e paprotezuar, ka qenë përfituese e grupit të I-rë me kujdestar, është komisionuar në datë 03.03.2021 dhe rezulton përfituese e nivelit të rëndë (3) pa kujdestar. - K.T me diagnozë amputacion traumatik i anësisë së poshtme, i paprotezuar, rezulton përfitues i nivelit të moderuar. J.Ç është komisionuar në komisionin e shqyrtimit të ankesave në datë 14.04.2021, vendim i cili do shkojë në njësinë administrative, ku J.Ç është banor”*.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

² Referuar dokumentit: Lajmërim marrje poste, nr. RR627523563AA dhe nr. RR623942366AA.

- Me Vendimin nr. 5168, datë 22.10.2019 të lëshuar nga KMCAP i PAK Tiranë, J.Ç është caktuar si PAK i grupit të I-rë, ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi, dhe afati i rikontrollit në KMCAP pas një viti.
- Me njoftimin e Vendimit datë 01.12.2020 të lëshuar nga Zyra Rajonale e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, komisioni multidisiplinar ka vendosur përfitimin e pagesës mujore të aftësisë së kufizuar për J.Ç, si përfitues i nivelit të 3-të (i rëndë) për një vit, me diagnozë, amputacion traumatik i anësive të poshtme e paprotezuar, por nuk ka dhënë rekomandim për ndihmës personal.
- Ankuesi nuk ka rënë dakord me vendimin për mospërfitimin e ndihmësit personal dhe ka kundërshtuar vendimin pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH.
- Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave me njoftimin e Vendimit datë 24.05.2021 ka vendosur vetëm përfitimin e pagesës mujore për J.Ç, si përfitues i nivelit të 3-të (i rëndë).

Në nenin 8/c) të ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se, një ndër kategoritë përfituese të pagesës për aftësinë e kufizuar janë: “c) personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar”, ndërsa në nenin 10 përcaktohet se: “Personat përfitues, që përcaktohen në gerrat a, b dhe c, të nenit 8, të këtij ligji, të cilët, me vendim të komisioneve të vlerësimit, të parashikuar nga ky ligj, përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një ndihmës personal me pagesë”.

Në pikën I/1 dhe 2, të VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar” e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, përcaktohet se: “Modeli biopsikosocial i vlerësimit të aftësisë së kufizuar do të zbatohet në qarqet Tiranë, Durrës dhe Elbasan, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, afateve të përcaktuara në Vendimin nr. 380, datë 5.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit politik ‘Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019–2024 për zbatimin e tij’”, dhe nëpërmjet përdorimit të Regjistrit Elektronik Kombëtar. 2. Në vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar do të përfshihen individët, që: a) kërkojnë të vlerësohen për herë të parë; b) kërkojnë të rivlerësohen, të cilët kanë përfituar pagesë të aftësisë së kufizuar sipas legjislacionit në fuqi”.

Bazuar në ndryshimet ligjore të mësipërme të bëra në vitin 2019, subjekti ankues i është nënshtruar vlerësimit bio-psiko-social nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Në pikën IV/14 dhe 15, të VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019, të sipërcituar, përcaktohet se: “Personat me aftësi të kufizuara me kufizime të rënda apo të thella gëzojnë të drejtën e përfitimit të ndihmësit personal, kur kjo përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë

së kufizuar. 15. Shkalla e nevojës për shërbimet e ndihmësit personal përcaktohet në bazë të vlerësimit biopsikosocial të kryer nga komisioni shumëdisiplinor”.

Në pikën V/1 dhe 2, të VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019, të sipërcituar parashikohet procedura e ankimit. Kështu, në kreun V, përcaktohet se: “1. Aplikuesi ka të drejtën e ankimit për procedurën e vlerësimit në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar. Ankimimi bëhet me shkrim, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit të vendimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, e cila shqyrton dokumentacionin e ankimesit, kryen intervistën sipas formularit 6, bashkëlidhur këtij vendimi dhe merr vendimin përfundimtar. Në rastet kur kërkesa pranohet, personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji pasardhës, nga data e marrjes së vendimit për refuzim nga komisioni. 2. Personi me aftësi të kufizuar, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, pasi ka ezauruar shkallët e ankimit administrativ. Personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve, sipas afateve të përcaktuara në vendimin e gjykatës”.

Sikurse vihet re nga parashikimet e mësipërme, të VKM-së nr. 722, datë 11.11.2019, është komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar, i cili bën vlerësimin e gjendjes shëndetësore të personit me aftësi të kufizuar, bazuar në vlerësimin biopsikosocial, nëse ai mund të përfitojë ndihmësin personal, më pas komisioni i shqyrtimit të ankesave merr vendimin përfundimtar dhe në vijim personi mund ti drejtohet gjykatës administrative për të kërkuar të drejtën e tij.

Lidhur me diagnozën e aftësisë së kufizuar që mban ankuesi, në udhëzuesin për vlerësimin Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar tek të Rriturit, është parashikuar se: “*Amputacioni traumatik i anësive të poshtme, e paprotezuar ICD 10-15: T13.6. Me amputacion traumatik kuptohet humbja e plotë ose e pjesshme e njëres ose të dy anësive të poshtme, si pasojë e një ngjarje traumatike apo si procedurë kirurgjikale e domosdoshme, kur anësia bëhet tërësisht jo funksionale apo rrezikon jetën e pacientit.....Humbja e anësive të poshtme çënon seriozisht aftësinë e individit për të lëvizur, vetëshërbyer apo për të marrë pjesë në jetën sociale. Në amputimet e paprotezuara humbet tërësisht si aftësia për t’u spostuar nga një ambient në tjetrin, ashtu dhe aftësia për punë. Individët e protezuar mund të përshkojnë distanca të vogla apo të realizojnë veprimtari intelektuale me kohë të pjesshme*”.

Bazuar në sa më sipër dhe në dokumentacionin e depozituar, rezulton se vendimi i komisionit shumëdisiplinor, bazohet në intervistën e zhvilluar dhe lidhet kryesisht me vlerësimin dhe caktimin e diagnozës mjekësore. Për shkak të natyrës specifike, Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar është një ekip i përzgjedhur, i përbërë nga mjekë dhe punonjës social, të cilët janë të punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe janë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit bio-psiko-social të aplikuesve për përfitimet për shkak të

aftësisë së kufizuar, bazuar në dokumentet e përgatitura nga institucionet shëndetësore, informacionin e marrë nga intervistat e zhvilluara, verifikimin dhe shkëmbimin e informacionit me institucione të tjera sociale, arsimore, shëndetësore, të punësimit e formimit profesional.

Bazuar në informacionin e dërguar nga DRSHSSH Tiranë³, vërtetohet se nga ana e komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar është mbajtur i njëjti qëndrim dhe në shqyrtimin e praktikës së pacientes M.T, me diagnozë amputacion traumatik i anësive të poshtme e paprotezuar, përfitues i nivelit të rëndë (3) pa kujdestar.

Sa më sipër, mbështetur në Ligjin nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se J.Ç nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, nga ana e DRSHSSH Tiranë, për shkak të gjendjes shëndetësore.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3/1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjerash personash, përbën diskriminim”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë.

³ Referuar shkresave nr. 252/1, datë 25.02.2021 dhe nr. 440/2, datë 20.04.2021.

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues, nuk mund të ketë diskriminim për shkakun e pretenduar në ankesë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 20/1, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të J.Ç, për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA